

RAPORTIMI I REFORMËS
NË DREJTËSI NGA
MEDIAT SHQIPTARE:
*mes interesit publik dhe
klientelizmit politik*

RRAPO ZGURI

DARIAN PAVLI



Tiranë, 2018

Botues:



**Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias**

Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania

Tel./fax: ++ 355 4 2229800

E-mail: info@institutemedia.org

www.institutemedia.org

Autorë:

Rrapo Zguri

Darian Pavli

Ky raport është pjesë e projektit “Reforma në drejtësi në median shqiptare”, i mbështetur financiarisht nga Ambasada Britanike në Shqipëri. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e Institutit Shqiptar të Medias dhe nuk reflekton pikëpamjet e donatorit.

Treguesi i lëndës

1	Hyrje	5
2	Konteksti i reformës në drejtësi	8
2.1.	Shtysat kryesore të reformës	8
2.2.	Roli dhe pozicionimi i Këshillave dhe SPAK-ut	14
2.2.1.	<i>Përzgjedhja dhe funksionet e dy Këshillave ..</i>	<i>15</i>
2.2.2.	<i>Përzgjedhja dhe funksionet e organeve të SPAK-ut</i>	<i>19</i>
3	Mbulimi i reformës në drejtësi nga mediat shqiptare	23
3.1.	Tablo e gjetjeve sasimore	25
3.2.	Akset kryesore dhe problematika e raportimit të mediave për reformën në drejtësi	32
	<i>Raportim i politizuar dhe klientelizëm politik</i>	<i>38</i>
	<i>Media si ndërmjetësuese e pingpongut politik</i>	<i>42</i>
	<i>Faktori ndërkombëtar: vlerësime dhe paragjykime</i>	<i>44</i>
	<i>Tabloidizim dhe personalizim i informimit</i>	<i>49</i>
4	Përfundime	52



Hyrje

Pas më shumë se një çerek shekulli tranzicion drejt demokracisë, Shqipëria ende ballafaqohet me një numër problemesh që po pengojnë dhe vonojnë plotësimin e standardeve bazë të një shoqërie liberale demokratike dhe anëtarësimin e vendit në BE. Raportet ndërkombëtare dhe ato të shoqërisë civile theksojnë se një nga problemet më të mprehta aktualisht në Shqipëri mbetet keqfunksionimi dhe korrupsioni i lartë në sistemin e drejtësisë, që ka sjellë pasoja negative në luftën kundër krimit dhe korrupsionit dhe në ritmet e zhvillimit të vendit në përgjithësi.

Për t'i dhënë zgjidhje kësaj situate, në korrik 2016, Kuvendi i Shqipërisë, me asistencën dhe mbështetjen e aleatëve perëndimorë, hartoi dhe miratoi një paketë amendimesh kushtetuese që do të krijonin bazën për një reformim rrënjësor të sistemit të drejtësisë. Mes të tjerash, ndryshimet ligjore parashohin edhe ngritjen e tre institucioneve të rëndësishme të sistemit të ri të drejtësisë dhe përkatësisht, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Strukturës së Posaçme Antikorrupsion dhe kundër Krimit të

Organizuar (SPAK), të cilat parashikohet të kenë një shkallë të lartë pavarësie dhe një impakt thelbësor në luftën kundër krimit dhe korrupsionit.

Gjatë dy viteve të fundit vendi ka kaluar sfida të panumërta për implementimin e kësaj reforme. Mediat kanë luajtur një rol të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm në informimin e publikut rreth këtyre zhvillimeve, duke e kthyer reformën në drejtësi në një nga kryetemat e axhendës së debatit publik dhe duke nxitur përshpejtimin e ritmeve të saj. Por nuk kanë munguar edhe problemet në mbulimin e kryer nga ana e mediave.

Ky punim synon të paraqesë një tablo të kontekstit të zhvillimit të reformës në drejtësi si dhe të analizojë mbulimin e mediave për çështjet dhe zhvillimet që lidhen me reformën në përgjithësi, dhe çështjet dhe zhvillimet që lidhen me krijimin e KLGJ, KLP dhe SPAK në veçanti.

Kërkimi i zhvilluar në kuadër të këtij punimi ka përfshirë monitorimin e katër gazetave të përditshme (Panorama, Tema, Shqiptarja.com dhe Shekulli), dy kanaleve televizive kombëtare (Klan dhe Top Channel) si dhe dy portaleve të lajmeve (syri.net dhe javanews.al) gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2017, për të evidentuar termat sasiore të mbulimit nga ana e medias si dhe linjat kryesore të diskursit mediatik që lidhet me reformën në drejtësi dhe problematikën e hasur në raportimin e mediave.

Megjithëse zhvillimet më të fundit për zgjedhjen e anëtarëve të dy Këshillave në Kuvend ndodhën pas periudhës së monitorimit, u jemi referuar shkurtimisht këtyre zhvillimeve në përfundimet e këtij studimi. Konstituimi i organeve të SPAK-ut nuk ka filluar ende sepse varet institucionalisht nga krijimi i KLGJ-së dhe KLP-së, të cilat nuk janë ende funksionale.



Konteksti i reformës në drejtësi

Në vijim të këtij kreu, do të ndalemi fillimisht te shtysat kryesore që krijuan premisat për ndërmarrjen e reformës në drejtësi. Pjesa e dytë e kontekstit do të analizojë mënyrën e krijimit të dy Këshillave dhe strukturave të SPAK-ut, si dhe funksionet e tyre më të rëndësishme.

2.1. Shtysat kryesore të reformës

Politizimi dhe mungesa e pavarësisë, mungesa e përgjegjshmërisë dhe tolerimi i korrupsionit masiv në sistem ishin faktorët kryesorë që krijuan nevojën e një reforme të thellë.

Pikësëpari, politizimi i sistemit ka pasur shkaqe dhe dimensione të ndryshme, të cilat lidhen në një masë të madhe me kulturën politike të vendit, mungesën e traditës së një gjyqësori të pavarur dhe kriminalizimin e një pjese të klasës politike. Megjithatë, disa defekte të kuadrit kushtetues dhe institucional kanë kontribuar dukshëm në krijimin e kushteve për politizim, hera-

herës të skajshëm, sidomos në emërimet e organeve më të larta të pushtetit gjyqësor. Ndër këto, duhet veçuar roli i luajtur nga Presidenti i Republikës.

Në konceptin fillestar të Kushtetutës së vitit 1998, figura e një presidenti “super partes” ishte ideuar, ndër të tjera, si një garant i pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe institucioneve të tjera autonome. Kështu, presidenti kishte një rol qendror në procesin e përzgjedhjes së të gjithë kupolës së gjyqësorit dhe prokurorisë, përfshirë këtu anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, si dhe prokurorin e përgjithshëm. Kandidatët e propozuar nga presidenti duhet të konfirmoheshin me pëlqimin e shumicës së Kuvendit¹.

Parakushti bazë për funksionimin e kësaj formule ishte zgjedhja e një kryetari shteti që ishte realisht mbi palët. Hartuesit e Kushtetutës së 1998-ës ishin të vetëdijshëm se kjo do të ishte një sfidë jo e vogël për demokracinë e re shqiptare; ata u përpoqën ta zgjidhin problemin nëpërmjet një formule mjaft komplekse për zgjedhjen e vetë presidentit nga një shumicë e cilësuar në Kuvend, çka do t'i shtynte palët të gjenin një kandidat kompromisi. Por kjo formulë kushtetuese krijoi aq shumë pakënaqësi për dy partitë dominuese të politikës shqiptare (Demokratët dhe Socialistët), sa në

¹ Po ashtu, presidenti emëronte edhe gjyqtarët dhe prokurorët e zakonshëm, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) dhe prokurorit të përgjithshëm, respektivisht. Së fundmi, presidenti kryesonte dhe vetë KLD-në dhe mbledhjet e saj.

vitin 2008 PD dhe PS bashkuan votat për ndryshimin e formulës kushtetuese, thuajse pa asnjë konsultim publik. Formula e re bënte të mundur zgjedhjen e presidentit vetëm me votat e shumicës në pushtet, gjë që me kalimin e kohës solli në skenë presidentë që nuk kishin mbështetje multipartiake.

Vetëkuptohet se ky ndryshim kushtetues vuri në dyshim gjithë skemën e ndarjes së pushteteve dhe sidomos krijoi pasoja negative për gjyqësorin pasi opinioni publik humbi besimin në pavarësinë e emërimeve në gjykata dhe sistemin e prokurorisë, të cilat u politizuan gjithnjë e më tepër. Këto procese u bënë kaq konfliktuale sa që deri vonë, asnjë prokuror i përgjithshëm nuk e përfundoi dot mandatin e vet kushtetues, duke u shkarkuar nga shumica parlamentare e radhës. Po ashtu, në vitet e fundit, një numër vendesh vakante në gjykatën e lartë dhe kushtetuese mbetën pa u plotësuar për muaj me radhë për shkak të mosdakordimit mes presidentit dhe shumicës parlamentare të kahut tjetër. Ky i fundit ishte efekti tjetër madhor i ndryshimeve të 2008-ës: ngërçet e vazhdueshme institucionale (“deadlock situations”) që nuk gjenin zgjidhje kushtetuese. Sistemi kishte dy mënyra (mos)funksionimi: ose emërime të njëanshme, ose bllokime të zgjatura, të cilat nuk mund të mos dëmtonin imazhin dhe besueshmërinë e gjithë sistemit gjyqësor. Amendimet e 2008-ës rrëzuan edhe atë mur të hollë që rrekej ta izolonte gjyqësorin nga konfliktualiteti ekstrem i jetës politike shqiptare.

Kjo na sjell, **së dyti**, në temën e pandëshkueshmërisë brenda vetë sistemit gjyqësor dhe prokurorial, i cili u tregua i paaftë të pastronte “mollët e këqija” nga radhët e veta. Kjo ishte pjesërisht pasojë e sa më sipër, pasi emërimet politike pa “checks and balances” sollën mjaft individë problematikë në radhët e gjyqësorit. Por edhe këtu kishte disa defekte institucionale (në retrospektivë) që buronin prej vetë Kushtetutës së 2008-ës: në radhë të parë, formula për përzgjedhjen e KLD-së, organit qeverisës së gjyqësorit, që krijoi një korporatizëm të theksuar. Duke qenë se dy të tretat e anëtarëve të KLD-së (10 nga 15) zgjidheshin nga vetë trupa gjyqësore e republikës, institucioni zhvilloi një “mentalitet gildi” ku shumica e dominuar nga anëtarët gjyqtarë mbronin kolegët e tyre në procedimet disiplinore dhe aspekte të tjera që kanë të bëjnë me integritetin dhe profesionalizmin e gjyqtarëve².

Situata ishte akoma më problematike në sistemin e prokurorisë, i cili drejtohej nga figura e gjithëfuqishme e prokurorit të përgjithshëm (PP), me një nivel shumë të lartë centralizimi të kompetencave në duart e këtij të fundit. Ndërkohë, vetë përzgjedhja e PP ishte rezultat i një procesi tërësisht politik, sipas formulës tashmë

² Kuptohet, këtu kishte edhe faktorë të tjerë kontribues, sepse një masë kritike e shëndoshë brenda KLD-së natyrisht që mund të kishte luajtur një rol tjetër. Për më tepër, fakti që KLD-ja kryesohej nga presidenti i republikës, me praninë e ministrit të drejtësisë dhe tre anëtarëve të tjerë laikë (jo-gjyqtarë) të zgjedhur direkt nga Kuvendi krijoi premisat për politizimin e këtij organi, i cili vitet e fundit u bë gati jofunksional.

standarde të emërimit nga presidenti, me pëlqimin e Kuvendit me shumicë të thjeshtë. Ashtu si në sistemin gjyqësor, kjo formulë gjeneronte të njëjtën situatë binare: ose emërimë të njëanshme, ose bllokim total. Fakti që PP emërohej për një periudhë 5-vjeçare, por me të drejtë riemërimi të pakufizuar, krijonte varësi të kuptueshme dhe të pashëndetshme politike për këtë pozicion kyç (në fakt, nga të dyja anët e politikës).

Ndërkohë, pjesa tjetër e hierarkisë së prokurorisë ishte tërësisht në dorën e dy personave: të gjithë prokurorët e tjerë emëroheshin në detyrë (dhe shkarkoheshin apo transferoheshin) nga presidenti, me propozimin e PP-së. Pra edhe kontrolli i integritetit, profesionalizmit dhe ngritjes në detyrë ishte në dorën e këtij mekanizmi të centralizuar, i cili në praktikë nuk garantoj dot një sistem meritokratik mbi të cilin ngrihet sot çdo prokurori moderne. Si rrjedhim, sistemi prokurorial vuan nga të njëjtat deficite si dhe gjyqësori (në mos dhe më të rënda) në aspektet e politizimit, korrupsionit dhe inefiçensës. Për më tepër, një prokurori e dobët dhe e lidhur me “fije të fshehta” me politikën dhe krimin e organizuar ka qenë e paaftë të luajë rolin thelbësor që i takon në “pastrimin” dhe dekriminalizimin e të gjithë sistemit tonë politik, ekonomik, etj.

Së treti, niveli galopant i korrupsionit në radhët e sistemit tonë të drejtësisë ishte një nga shtysat themelore për reformën, sidomos parë nga prizmi i opinionit publik. Për këtë aspekt është shkruar dhe debatuar shumë dhe ndoshta nuk është nevoja të

ndalemi gjatë, por është e udhës të theksojmë disa aspekte të arkitekturës institucionale. Që prej vitit 2004, kanë filluar funksionimin gjykata dhe prokuroria e posaçme (në shkallë të parë dhe apel) për krimet e rënda, të cilat janë specializuar fillimisht në ndjekjen e kriminalitetit të organizuar dhe më vonë edhe në veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv³. Ndërkohë që funksionimi i këtij aparati gjyqësor-prokurorial të posaçëm ka pasur efekte deri diku pozitive në luftën kundër krimit të organizuar, sukseset në ndjekjen penale të korrupsionit madhor – qoftë në sferën politiko-ekonomike, qoftë brenda vetë radhëve të gjyqësorit – kanë qenë modeste dhe të pamjaftueshme.

Pjesa më e dobët e këtij mekanizmi ka qenë prokuroria dhe aparati hetimor, duke qenë se edhe prokuroria e posaçme ka qenë pjesë e sistemit unik të prokurorisë, me në krye dhe nën mbikëqyrjen e prokurorit të përgjithshëm. Në terma konkretë, prokurorëve të krimeve të rënda u ka munguar autonomia ligjore dhe praktike për të ndjekur fijet e korrupsionit “atje ku ato çojnë.” Në të njëjtën kohë, atyre u ka munguar edhe mbështetja e një strukture të pavarur dhe të specializuar hetimore, të ndryshme nga policia gjyqësore aktuale, me një distancë të shëndetshme nga pushteti ekzekutiv, i cili duhet të jetë një nga objektet e veprimtarisë së tyre. Të gjitha këto dobësi krijuan premisat për

³ Shih <http://www.gjykata.gov.al/apel-krimet-e-r%C3%ABnda/gjykata-e-apelit-krimet-e-r%C3%ABnda/gjykata/rreth-gjykat%C3%ABs/>.

krijimin e të ashtuquajturës Strukturës së Posaçme Anti-korrupsion dhe kundër Krimit të Organizuar (SPAK), e cila përfshin një komponent prokurorial të pavarur nga prokurori i përgjithshëm dhe hierarkia e prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm; si dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) si një organ i specializuar hetimor në shërbim të SPAK-ut.

2.2. Roli dhe pozicionimi i Këshillave dhe SPAK-ut

Me reduktimin e rolit të organeve politike (presidentit, parlamentit, ministrit të drejtësisë etj) në formëzimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të drejtësisë, ndryshimet kushtetuese të mesvitit 2016 rritën në mënyrë proporcionale rolin dhe rëndësinë e organeve të tjera teknike dhe në mënyrë të veçantë të dy organeve qeverisëse të sistemit, KLGJ-së dhe KLP-së.

Kështu p.sh, në sistemin e ri anëtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga presidenti i republikës, me propozimin e KLGJ-së, duke anashkaluar tërësisht Kuvendin, me idenë se Gjykata e Lartë duhet të jetë një trupë teknike karriere, personeli i të cilës duhet të vijë nga radhët e gjyqtarëve (80%) dhe juristëve apo profesorëve të së drejtës (20%) më të shquar të vendit⁴.

⁴ Edhe roli i presidentit është gati formal në këtë proces, sepse shumica e KLGJ-së mund të konfirmojë në detyrë edhe kandidatët që refuzohen të miratohen nga presidenti (një lloj vetoje relative).

Në të njëjtën linjë, KLP-ja tashmë do të luajë një rol të rëndësishëm në propozimin e prokurorit të përgjithshëm, duke i përcjellë Kuvendit tre kandidatë për këtë pozicion. Kuvendi zgjedh njërin prej tre kandidatëve me 3/5 e votave. Në rast se Kuvendi nuk e krijon dot shumicën e nevojshme brenda 30 ditëve, kandidati i renditur i pari nga KLP-ja konsiderohet i zgjedhur.

Por, paradoksalisht, fuqizimi i rolit kushtetues të këshillave shtoi interesin e faktorëve politikë në mënyrën e krijimit të vetë këshillave, e cila u kthye në një “mollë sherri” të stërzgatur në procesin e miratimit të amendimeve kushtetuese. Në fakt, kjo pikë ishte ndër elementët më konfliktualë të procesit dhe u zgjidh vetëm me anë të një kompromisi të komplikuar të minutës së fundit.

Në vijim, do të ndalemi shkurtimisht te formula e përzgjedhjes së dy këshillave qeverisëse dhe organeve të SPAK-ut, dhe funksionet e tyre kryesore.

2.2.1. Përzgjedhja dhe funksionet e dy Këshillave

KLKJ-ja dhe KLP-ja përbëhen nga 11 anëtarë; mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të të dy trupave është praktikisht e njëjtë. 6 prej tyre zgjidhen, respektivisht, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve të të tre niveleve (dmth në shkallë të parë, apel, dhe kasacion) në shkallë vendi.

5 anëtarët laikë (jo magjistratë) përzgjidhen si më poshtë: 2 nga radhët e avokatëve të licencuar, 2 mes pedagogëve të së drejtës (njeri prej të cilëve nga trupa mësimdhënëse e Shkollës së Magjistraturës) dhe një përfaqësues i shoqërisë civile të organizuar. Të gjithë kandidatët laikë duhet të kenë të paktën 15 vjet përvojë profesionale si jurist, si dhe integritet moral dhe profesional të lartë. Kandidimi është i hapur, por Kushtetuta dhe ligji implementues përcaktojnë një sërë filtrash institucionale, të cilat verifikojnë nëse kandidatët përmbushin kriteret ligjore dhe bëjnë një para-seleksionim të tyre, duke përzgjedhur të paktën tre kandidatët për çdo pozicion vakant⁵.

Përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve jo-magjistratë e bën Kuvendi, i asistuar nga një nënkomision i posaçëm i Komisionit të Ligjeve, prej pesë anëtarësh (3 nga shumica parlamentare, 2 nga opozita). Ky nënkomision duhet të miratojë, me 4 vota, një listë unike të 5 kandidatëve laikë për secilin nga dy Këshillat dhe t'ia përcjellë ato seancës plenare të Kuvendit. Ky i fundit duhet ta miratojë listën me një supershumicë prej 2/3 të të gjithë deputetëve; në të kundërt, nënkomisioni e ribën procesin nga e para.

Të vetëdijshëm për historinë e bllokimit të emërimeve që kërkojnë shumicë të cilësuar në Shqipëri, hartuesit e Kushtetutës ranë dakord edhe

⁵ Shih Ligjin nr 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

për një mekanizëm zhbllokimi (“anti-deadlock”) të dyfishtë: nëse nënkomisioni nuk arrin të miratojë ndonjë nga kandidatët e listës me 4 vota, kandidati në fjalë zgjidhet me short (brenda listës përkatëse të avokatëve, pedagogëve dhe shoqërisë civile). Dhe nëse Kuvendi nuk e miraton listën e nënkomisionit me 2/3 pas tri përpjekjeve të njëpasnjëshme, lista e tretë e nënkomisionit konsiderohet e zgjedhur.

Kjo formulë mjaft komplekse dëshmon për rëndësinë me të cilën janë trajtuar këshillat nga faktorët politikë dhe kushtetutë-bërës për të shmangur kontrollin e tyre nga njëra apo tjetra palë, apo dhe faktorë të tjerë malinjë (si krimi i organizuar). Por mekanizmat e zhbllokimit kanë brenda edhe një dimension paradoksal, sepse në mungesë të një konsensusi mes palëve kryesore, përbërja e këshillave vendoset, në llogari të fundit, nga shorti. Një proces i zgjatur dhe i mirë-rregulluar, me kritere dhe procedura të shumta, potencialisht nuk kulmon me zgjedhjen e kandidatëve më të mirë, por me një zgjidhje të rastësishme. Mbetet për të parë se çfarë pasojash do të sjellë kjo situatë për mbarëvajtjen e punës së dy Këshillave.

Sipas Kushtetutës, KLGJ-ja ushtron këto funksione kryesore:

- a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;
- b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve;

- c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit;
- ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
- d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave ...;
- dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave;
- e) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor;
- ë) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

Në krahasim me kompetencat e KLD-së së vjetër, funksionet e KLGJ-së janë forcuar në mënyrë të konsiderueshme, sidomos në aspektin e propozimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, administrimit e buxhetit gjyqësor dhe mbikëqyrjen e administratës së gjykatave.

Roli i KLP-së është forcuar në mënyrë akoma më të theksuar, duke u transformuar nga një organ kryesisht këshillimor pranë prokurorit të përgjithshëm në një organ me tagër vendimmarrës mjaft të rëndësishëm. Kjo do të thotë, në anën tjetër, se kompetencat e prokurorit të përgjithshëm janë reduktuar ndjeshëm, duke decentralizuar qeverisjen e sistemit prokurorial. Përgjegjësitë e KLP-së mbi prokurorinë janë gati identike me ato të KLGJ-së mbi gjyqësorin, me përjashtim të faktit që administrata e prokurorisë do të menaxhohet në nivelin e çdo zyre prokurorie.

Një tjetër ndryshim i rëndësishëm për të dy këshillat është se anëtarët e tyre do të shërbejnë në këtë funksion me kohë të plotë, duke hequr dorë nga pozicionet që kanë mbajtur para emërimit⁶. Përkushtimi me kohë të plotë pritet të rrisë kolegjalitetin dhe profesionalizmin e këshillave, si dhe të reduktojë konfliktet e mundshme të interesit për anëtarët magistratë, të cilët më parë vazhdonin të ushtronin funksionet e tyre si gjyqtarë apo prokurorë.

Po ashtu, Kushtetuta dhe ligji parashohin mundësinë e komisioneve vendimmarrëse brenda dy këshillave, çka do të lejojë specializimin e anëtarëve në funksione të veçanta, si p.sh. shkeljet disiplinore, vlerësimi profesional apo ngritja në detyrë e magistratëve.

2.2.2. Përzgjedhja dhe funksionet e organeve të SPAK-ut

Organet kryesore janë Gjykata Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Prokuroria e Posaçme pranë kësaj gjykate, në shkallë të parë dhe apel. Të dyja këto struktura janë të ndara nga pjesa tjetër e gjyqësorit dhe sistemit prokurorial, respektivisht, dhe përbëjnë një sistem të mbyllur, në sensin që çështjet e hetuara nga prokuroria e posaçme gjykohen nga gjykatat e

⁶ Antarët magistratë kanë të drejtë të rikthehen në sistemin gjyqësor ose prokurorial, në nivel të njëjtë ose më të lartë, pas mbarimit të mandatit.

posaçme, në shkallë të parë dhe apel. E vetmja lidhje me pjesën tjetër të sistemit është Gjykata e Lartë, e cila mund të gjykojë ankimet (kasacionale) kundër vendimeve të gjykatës së posaçme të apelit, dhe këto vetëm në lidhje me interpretimin ose zbatimin e ligjit (jo vërtetimit të fakteve).

Është vetë Kushtetuta që parashikon krijimin e gjykatave dhe prokurorisë së posaçme, si dhe garancitë kryesore për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të tyre⁷. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme emërohen nga KLGJ-ja dhe mund të shkarkohen vetëm me votat e 2/3 së anëtarëve të KLGJ-së (8 vota nga 11). Para emërimit, kandidatët i nënshtrohen një verifikimi të posaçëm të pasurisë dhe integritetit të tyre, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve private. Edhe familjarët e tyre duhet t'u nënshtrohen këtyre kontrolleve për sa kohë që ushtrojnë funksionet.

Prokuroria e posaçme përbëhet nga të paktën 10 prokurorë, të cilët emërohen nga KLP-ja për një mandat 9-vjeçar të parinovueshëm. Ajo asistohet nga një njësi e posaçme hetimore (Byroja Kombëtare e Hetimeve), e cila është nën varësinë direkte të prokurorisë së posaçme. Është e rëndësishme të theksohet se të dyja këto organe janë të pavarura nga prokurori i përgjithshëm dhe mbikëqyren drejtpërsëdrejti nga gjykatat e posaçme dhe KLP-ja, e cila mund t'i shkarkojë

⁷ Neni 135 dhe neni 148/dh.

prokurorët e posaçëm me 2/3 e votave⁸. Prokurorët e posaçëm, oficerët e hetimit, personeli administrativ si dhe familjarët e tyre duhet t'u nënshtrohen të njëjtave kontrole fillestare dhe periodike të financave dhe komunikimeve si edhe gjyqtarët e posaçëm.

Juridiksioni material i gjykatave dhe prokurorisë së posaçme rregullohet nga neni 135 i Kushtetutës. Përveç veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, këto organe hetojnë dhe gjykojnë edhe akuzat e tjera penale kundër funksionarëve më të lartë të shtetit, përfshi presidentin e republikës, kryeministrin dhe ministrat, gjyqtarët e lartë, prokurorin e përgjithshëm, deputetët dhe kryetarët e bashkive⁹.

Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) është strukturë e specializuar e policisë gjyqësore, e cila heton veprat penale në juridiksionin e prokurorisë së posaçme, nën drejtimin dhe kontrollin ekskluziv të kësaj prokurorie. Drejtuesi i BKH-së emërohet nga KLP-ja me propozimin

⁸ Kundër vendimit të shkarkimit, gjyqtarët dhe prokurorët e posaçëm (ashtu si dhe gjyqtarët dhe prokurorët e zakonshëm) mund të ankohen në Gjykatën Kushtetuese, vendimi i së cilës është përfundimtar.

⁹ Po ashtu, ata kanë juridiksion edhe mbi akuzat penale ndaj antarëve të dy këshillave (KLP dhe KLGJ), të cilat janë organet përgjegjëse për emërimin dhe shkarkimin e tyre, çka krijon njëfarë tensioni institucional. Megjithatë, supershumica e nevojshme për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të posaçëm dhe kontrolli eventual i Gjykatës Kushtetuese veprojnë si kundërpesha ndaj konflikteve të mundshme të interesit.

e një komisioni të përbërë nga kryeprokurori i posaçëm dhe dy prokurorët më të vjetër në detyrë të kësaj prokurorie. Ai/ajo shërben për një mandat 5-vjeçar dhe mund të riemërohet vetëm për një mandat të dytë.

Duke qenë se emërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të posaçëm bëhet respektivisht nga KLGJ-ja dhe KLP-ja, procesi i emërimit të tyre mund të fillojë vetëm pas konstituimit dhe fillimit të funksionimit normal të dy këshillave.



3

Mbulimi i reformës në drejtësi nga mediat shqiptare

Gjatë viteve të fundit dhe sidomos pas miratimit nga Parlamenti të ndryshimeve kushtetuese në vitin 2016, reforma në drejtësi ka qenë dhe vijon të jetë një nga temat më të nxehta të debatit publik në Shqipëri. Në axhendën e vet, media i ka rezervuar një vend të konsiderueshëm raportimit dhe analizës së kësaj reforme, duke u bërë një faktor kyç jo vetëm për informimin e publikut, por edhe për nxitjen e implementimit të saj.

Për të krijuar një tablo të mbulimit nga ana e medias të reformës në drejtësi, janë monitoruar disa nga mediat kryesore në Shqipëri, duke bërë kujdes që kampioni i përzgjedhur për monitorim të jetë i balancuar. Në ndryshim nga shumë vende të tjera, në Shqipëri ndarja e majtë/e djathtë apo liberale/konservatore është e zbehtë si mes forcave politike, edhe mes mediave. Më pranë realitetit në rastin e mediave shqiptare është klasifikimi në media opozitare që shihen si më pranë opozitës dhe media pro mazhorancës që shihen si më pranë qeverisë apo forcave politike në pushtet.

Me këtë qasje metodologjike janë përzgjedhur për monitorim gazetat Panorama, Shekulli, Shqiptarja.com dhe Tema. Me të njëjtën logjikë janë përzgjedhur edhe dy mediat online, përkatësisht syri.net dhe javanews.al. Ndër kanalet televizive janë përzgjedhur për monitorim dy kanalet kombëtare Klan TV dhe Top Channel, të cilat reflektojnë ndarjet e mësipërme, por në terma më të zbehtë se sa gazetat dhe mediat online.

Periudha e përzgjedhur për monitorim është dy muaj, nga 1 nëntori 2017 deri në 31 dhjetor 2017. Monitorimi i gazetave ka përfshirë të gjithë numrat brenda kësaj periudhe. Kurse në rastin e dy kanaleve televizive, janë monitoruar edicionet kryesore të lajmeve të orës 19.30 për një javë të muajit nëntor (nga 15 deri në 21 nëntor) dhe një javë të muajit dhjetor (nga 15 deri në 21 dhjetor) duke përzgjedhur një javë ku rrjedha e ngjarjeve është normale dhe një javë tjetër ku arrihet në pikun e zhvillimeve lidhur me reformën në drejtësi, siç ishte java e dhjetorit gjatë së cilës u emërua kryeprokurori i përkohshëm. Për monitorimin e mediave online u përzgjedh kërkimi përmes fjalëkyçeve duke evidentuar dhe analizuar të gjitha shkrimet për reformën në drejtësi të botuara gjatë muajve nëntor dhe dhjetor në këto portale. Fjalëkyçet e përdorura ishin: reforma në drejtësi, KLP, KLGJ, SPAK, kryeprokurori, prokurori i përgjithshëm.

Natyrisht reforma në drejtësi ka vijuar edhe pas periudhës së përfshirë në monitorim, madje gjatë muajve janar dhe shkurt të vitit 2018 ka pasur zhvillime

shumë të rëndësishme në lidhje me objektin e kërkimit të këtij studimi, siç ka qenë maratona e bujshme e zgjedhjes së listës së anëtarëve të KLP dhe të KLGJ. Por nga një sy i shpejtë i këtyre zhvillimeve mund të arrihet në përfundimin se prirjet e përgjithshme të raportimit të medias dhe problematika e hasur gjatë periudhës së monitoruar për nevoja të këtij studimi, të cilat paraqiten dhe analizohen gjerësisht më poshtë, përkojnë apo janë të ngjashme me prirjet dhe problematikën që verifikohet gjatë janar-shkurtit 2015. Kësisoj mund të themi se përfundimet e këtij studimi kanë vlerë në përgjithësi për të gjithë procesin, pavarësisht stadeve nëpër të cilat ka kaluar ai.

3.1. Tablo e gjetjeve sasimore

Nga monitorimi sasior i katër gazetave të përditshme kombëtare rezulton se në përgjithësi ato e kanë përfshirë në axhendën e tyre reformën në drejtësi në një masë të konsiderueshme. Mesatarja e përgjithshme e shkrimeve për reformën në drejtësi për të katër gazetat në këtë periudhë është 1.7 shkrime për numër gazete. Por ndërkohë, brenda numrit të shkrimeve për reformën në drejtësi, numri i shkrimeve ku përmenden apo raportohet për KLP, KLGJ dhe SPAK është relativisht i vogël dhe zë nga 16 % (Tema) në 36 % (Shqiptarja.com) të tyre.

Tabela nr. 1: Numri i shkrimeve për reformën në drejtësi në shtypin shqiptar

Mediat	Nr. i shkrimeve për reformën	Nr. i shkrimeve ku flitet për KLP, KLGJ, SPAK	% e shkrimeve ku flitet për KLP, KLGJ, SPAK
Tema	112	18	16%
Shqiptarja.com	108	39	36%
Shekulli	83	18	22%
Panorama	110	26	24%

Po ta detajojmë kërkimin edhe më tej, duke parë se sa është numri i shkrimeve ku vetëm përmenden KLP, KLGJ dhe SPAK në kontekstin e zhvillimeve të tjera dhe sa është numri i shkrimeve që iu kushtohen tërësisht këtyre institucioneve, atëherë rezulton se ky numër është edhe më i vogël. Kështu tek Tema nga 18 shkrime ku përmenden KLP, KLGJ dhe SPAK, vetëm 1 shkrim i kushtohet tërësisht zhvillimeve që lidhen posaçërisht me këto institucione. Tek Shekulli nga 18 janë 5, tek Panorama nga 26 janë 9 kurse një raport disi më të lartë e ka Shqiptarja.com, në të cilën një e treta e shkrimeve (13 nga 39) merren vetëm me zhvillimet apo analizën e KLP, KLGJ dhe SPAK.

Në mediat online përqindja e shkrimeve ku përmenden apo raportohet për KLP, KLGJ dhe SPAK është edhe më e vogël. Siç e shohim dhe në tabelë, tek syri.net, vetëm 14 % e shkrimeve për reformën në drejtësi përmendin apo trajtojnë zhvillimet që lidhen me KLP, KLGJ dhe SPAK, kurse tek javanews.al kjo shifër shkon në 16 %.

Tabela nr. 2: Numri i shkrimeve për reformën në drejtësi në mediat online

Mediat	Nr. i shkrimeve për reformën	Nr. i shkrimeve ku flitet për KLP, KLGJ, SPAK	% e shkrimeve ku flitet për KLP, KLGJ, SPAK
Syri.net	175	24	14 %
Javanews.al	115	18	16%

Një situatë e ngjashme verifikohet edhe në mediat televizive. Kështu nga totali prej 32 minuta e 3 sekonda që zënë lajmet për reformën në drejtësi gjatë dy javëve të monitorimit në TV Klan, vetëm 6 minuta e 56 sekonda (ose 22% e kohës) iu kushtohen lajmeve që lidhen me KLP, KLGJ dhe SPAK. Në Top Channel kjo shifër është edhe më e vogël dhe shkon në 14 %.

Tabela nr. 3: Kohëzgjatja e lajmeve për reformën në drejtësi në kanalet televizive

Periudha	Kohëzgjatja e lajmeve për reformën	Kohëzgjatja e lajmeve për KLP, KLGJ, SPAK	% e kohës së lajmeve për KLP, KLGJ, SPAK
Klan TV	32:03	6:56	22%
Top Channel	45:09	6:36	14%

Përqindja relativisht e vogël e shkrimeve apo e kohës së transmetimit që lidhet me KLP, KLGJ dhe SPAK, zbulon një prirje të mediave shqiptare për të raportuar më shumë për zhvillimet që prodhohen nga debati

politik i ditës se sa nga hierarkia e rëndësisë së secilit komponent të reformës në drejtësi.

Tregues i kësaj prirjeje është edhe numri dhe përqindja e madhe që zënë shkrimet që lidhen me mbarimin e mandatit të ish-kryeprokurorit dhe zgjedhjen e kryeprokurorit të përkohshëm.

Si shihet edhe në tabelën e mëposhtme, shkrimet që lidhen çështjen e kryeprokurorit zënë nga 42 % (Shqiptarja.com) deri në dy të tretat (68% - Tema) e totalit të shkrimeve për reformën në drejtësi.

Tabela nr. 4: Numri i shkrimeve për çështjen e kryeprokurorit në shtypin shqiptar

Mediat	Nr. i shkrimeve për reformën	Nr. i shkrimeve për kryeprokurorin	% e shkrimeve për kryeprokurorin
Tema	112	76	68%
Shqiptarja.com	108	45	42%
Shekulli	83	48	58%
Panorama	110	63	57%

Edhe në mediat online situata është e ngjashme, madje në rastin e javanews.al, shkrimet për çështjen e kryeprokurorit zënë 77 % të totalit të shkrimeve për reformën në drejtësi.

Tabela nr. 5: Numri i shkrimeve për çështjen e kryeprokurorit në mediat online

Mediat	Nr. i shkrimeve për reformën	Nr. i shkrimeve për kryeprokurorin	% e shkrimeve për kryeprokurorin
Syri.net	175	109	62%
Javanews.al	115	89	77%

Një tablo e tillë pasqyron faktin që në prioritetet e veta media ndikohet në një masë jo të vogël prej axhendës publike të momentit dhe nuk ka ndonjë qasje që do të përcaktonte prioritetet afatgjata dhe një ndjekje të vazhdueshme të zhvillimeve.

Si ilustrim për këtë përfundim mund të përmendim edhe mënyrën tërësisht spontane të raportimit të mediave lidhur me zgjedhjen e anëtarëve të KLP. Siç dihet për rreth 10 muaj, që nga shkurti i vitit 2017, zgjedhja e KLP u vonua për shkak të mosparaqitjes së kandidaturave të mjaftueshme nga shoqëria civile, gjë që çoi në rihapjen e thirrjes për këtë pozicion deri në pesë herë. Për shumë kohë media e kaloi pothuajse në heshtje këtë ngërç tepër serioz dhe kujtohej të raportonte për të vetëm në rastet kur politika e sillte çështjen në arenën e debatit publik.

Mungesën e një politike editoriale proaktive dhe të një ndjekjeje konstante dhe të vazhdueshme në lidhje me reformën në drejtësi e provon edhe fakti që në periudha ku nuk ka patur ndonjë zhvillim të bujshëm, numri i shkrimeve për reformën ka qenë i vogël, edhe

pse reforma ka qenë në proces. Kështu gjatë nëntorit, numri i shkrimeve në gazeta ishte tre herë më i vogël se sa gjatë dhjetorit, muaj në të cilën pati zhvillime të bujshme lidhur me mandatin e ish-kryeprokurorit dhe zgjedhjen e kryeprokurorit të përkohshëm. Në mediat online shpërpjesëtimi është edhe më i lartë: gjatë dhjetorit janë botuar gjashtë herë më shumë shkrime për reformën se sa gjatë nëntorit. Kjo situatë paraqitet edhe në dy tabelat e mëposhtme.

Tabela nr. 6: Numri i shkrimeve për reformën në drejtësi në gazeta sipas muajve

Media	Nëntor	Dhjetor
Tema	25	87
Shqiptarja.com	41	67
Shekulli	21	62
Panorama	14	96
TOTALI	101	312

Tabela nr. 7: Numri i shkrimeve për reformën në drejtësi mediat online sipas muajve

Media	Nëntor	Dhjetor
Syri.net	32	143
Javanews.al	9	106
TOTALI	41	249

Edhe në mediat televizive verifikohet një shpërpjesëtim i thellë mes javës së nëntorit dhe javës së dhjetorit përsa i takon numrit të lajmeve që lidhen me reformën. Nëse gjatë javës së nëntorit në TV Klan kemi mesatarisht 0.4 lajme për reformën për 1 edicion lajmesh, në javën e dhjetorit kjo shifër arrin në 2.86 lajme për edicion. Në Top Channel, nga 0.57 lajme për edicion në javën e nëntorit, arrihet në 2.4 lajme për edicion në javën e dhjetorit. Më konkretisht paraqiten të dhënat në tabelë:

Tabela nr. 8: Numri i lajmeve për reformën në drejtësi në Klan TV dhe Top Channel

Media	Nr. lajmeve për reformën 15.11-21.11	Nr. lajmeve për reformën 15.12-21.12
Klan	3	20
Top Channel	4	17
Totali	7	37

Nga ky vëzhgim në rrafsh sasior mund të arrijmë në përfundimin se mediat shqiptare kanë mundur një mbulim relativisht të konsiderueshëm të reformës në drejtësi në përgjithësi, por do të duhet t'i kushtonin më shumë kohë dhe hapësirë komponentëve të tjerë të rëndësishëm të reformës, siç janë krijimi i KLP, KLGJ dhe SPAK, për të siguruar një shkallë proporcionaliteti më të lartë mes të gjitha aspekteve të reformës. Gjithashtu duhet një ndjekje në vazhdimësi dhe jo me hope apo

në raste zhvillimesh të bujshme. Politika editoriale e mediave duhet të jetë më proaktive, me një vizion më afatgjatë dhe sa më pak e ndikuar nga momenti apo nga axhenda e politikës.

3.2. Akset kryesore dhe problematika e raportimit të mediave për reformën në drejtësi

Gjatë viteve të tranzicionit mediat shqiptare kanë krijuar një përvojë që i ka maturuar profesionalisht dhe i ka bërë gjithnjë e më të angazhuara në misionin e tyre publik. Pa ngurrim mund të themi se edhe në Shqipëri janë të shumta rastet e gazetarisë së mirë, të përkushtuar dhe të ndershme, që vë në lëvizje shpeshherë gjithë shoqërinë duke e orientuar drejt kauzave të mëdha në shërbim të interesave të publikut. Këtë profil e kanë demonstruar edhe shumica e mediave shqiptare edhe në rastin e reformës në drejtësi, duke u pozicionuar qartazi në favor të saj dhe duke i krijuar gjithë hapësirën e duhur për të qenë në epiqendër të axhendës publike të ditës.

Nga monitorimi dhe analiza e përmbajtjes që lidhet me reformën në drejtësi dallohen qartë, nga njëra anë diskursi vlerësues për reformën dhe, nga ana tjetër diskursi që lidhet me domosdoshmërinë dhe urgjencën e implementimit të saj. Në përgjithësi në media nuk ka zëra kundër reformës si e tillë, por vetëm për mënyrën se si po implementohet ajo, për vonesat, bllokimin apo politizimin e saj.

Autorë të ndryshëm dallojnë tek reforma një *momentum* historik teksa shohin të mbërrijë më në fund “ora e drejtësisë për shqiptarët”¹⁰. Gjithashtu i shohin zhvillimet në një kontekst të gjerë historik dhe shoqëror.

Për autorin e shkrimit *Si u bënë shqiptarët me drejtësi* të botuar në gazetën Panorama, reforma aktuale shënon përpjekjen e tretë madhore për të reformuar sistemin e drejtësisë në Shqipëri, pas përpjekjes së parë të kryer në vitet '30 të shekullit të kaluar në qeverisjen e Ahmet Zogut, dhe pas përpjekjes së dytë që u bë në vitet e para pas rënies së komunizmit¹¹. Në terma glorifikues një autor tjetër e sheh reformën në drejtësi dhe vetingun si “fitorja e dytë pas asaj të Pavarësisë” sepse “me fitoren e drejtësisë fillon vullshëm edhe konsolidimi i lirisë, pavarësisë, progresit, emancipimit, demokracisë dhe i integritetit të Shqipërisë.”¹²

Krahas kontekstit historik, reforma shihet nga disa autorë edhe në kontekstin gjeopolitik. “E ngërthyer në marrëdhënie të shumta me BE-në dhe NATO-n, Shqipëria është pjesë e një vendi më të madh sesa duket në hartën e saj. Janë pikërisht këto marrëdhënie, që nuk të lejojnë të mendosh si zakonisht. Pozicioni

¹⁰ S.S.Kapiti, *Pas 100 vitesh filloi të punojë ora e drejtësisë*, Shekulli, 5 Nëntor 2017

¹¹ L. Lita, *Si u bënë shqiptarët me drejtësi*, Panorama, 23 nëntor 2017

¹² S.S.Kapiti, *Pas 100 vitesh filloi të punojë ora e drejtësisë*, Shekulli, 5 Nëntor 2017

gjeografik i Shqipërisë, kalimi në rrugët, doganat apo marrëdhëniet në fushën e bujqësisë, pra të ushqimit të përbashkët, imponojnë Evropën në një tjetër qasje të tipit radikal dhe gjithëpërfshirës”¹³ - thuhet në një artikull për reformën në drejtësi të botuar në javanews.al. Në një artikull tjetër që vlerëson rolin e SHBA në lidhje me reformën, lexojmë: “SHBA konstatuan se sistemi vendas i drejtësisë ishte dobësia strukturore e aleatit strategjik në brigjet e Adriatikut.”¹⁴

Brenda kontekstit gjeopolitik, në mediat e monitoruara gjejmë edhe vlerësimin për rolin e BE dhe të SHBA të cilët iniciuan dhe mbështetën reformën në drejtësi. Ndryshimet kushtuese të vitit 2016, cilësohen nga një autor si një investim i drejtpërdrejtë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.¹⁵ Kurse në një shkrim tjetër lexojmë: “Më në fund falë tërësisht vullnetit dhe këmbënguljes së SHBA dhe të BE-së, tashmë me fillimin e funksionimit të Vetingut fillon të punojë edhe ora e koha për shqiptarët, për shtetin modern shqiptar dhe për kombin shqiptar”.¹⁶

Në mediat e monitoruara pasqyrohet dhe reflektohet edhe pritshmëria e lartë e publikut për rezultatet dhe

¹³ <http://www.javanews.al/llogaritari-calaman-kryeprokurori-dhe-vdekja-e-klases-politike/>

¹⁴ L. Lita, *Si u bënë shqiptarët me drejtësi*, Panorama, 23 nëntor 2017

¹⁵ Po aty

¹⁶ S.Kapiti, *Pas 100 vitesh filloi të punojë ora e drejtësisë*, Shekulli, 5 Nëntor 2017

efektet e reformës në tërë sistemin e drejtësisë. Por siç thekson një autor, me finalizimin e reformës në drejtësi lidhen edhe pritshmëria dhe makthi i politikës. Kësisoj, edhe pse është një proces dhe reformë me natyrë juridike, prej saj priten efekte edhe lidhur me transformimin e politikës. “Për mendimin tim, ka për të shkukur nga rrënjët një klasë të tërë politike”¹⁷, shkruan një autor në analizën e tij për vetingun dhe reformën në drejtësi. Ndërkohë procesi i nisur vlerësohet se “ka hyrë në një rrugë pa kthim”¹⁸

Në një kontekst më të gjerë, sipas disa autorëve, nga reforma pritet gjithashtu që të ketë një efekt edhe për vetë demokracinë dhe për shtetin, dhe si rrjedhim edhe për jetën dhe mirëqenien e qytetarëve si dhe për liritë dhe të drejtat e tyre.

Në mediat e monitoruara gjejmë gjithashtu të pasqyruar dhe të shprehur edhe vlerësimin si dhe shqetësimet që lidhen me institucionet e reja që do të ngrihen në kuadër të reformës në drejtësi, siç janë KLP, KLGJ dhe SPAK të cilat janë edhe në fokus të veçantë të këtij studimi. Autori i shkrimit “*Pritshmëritë për 2018 në Reformën në Drejtësi/ Kush do të kalojë në filtrat e SPAK...*” thekson se “rezultatet e para të vetingut, formimi i Këshillit të Lartë të

¹⁷ <http://www.javanews.al/llogaritari-calaman-kryeprokurori-dhe-vdekja-e-klases-politike/>

¹⁸ <http://www.javanews.al/spak-makthet-e-politikes-dosjet-dhe-zyrtaret-e-shenjestrar/>

Prokurorisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor e mandej ngritja e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të organizuar, e njohur si SPAK, si edhe zgjedhja e një Prokurori të Përgjithshëm me një mandat 7 vjeçar pritet të tregojnë vullnetin politik për zbatimin e kësaj reforme.”¹⁹ I njëjti autor thekson se pritshmëria më e lartë publike është për SPAK, strukturën e veçantë që do të hetojë dhe vendosë para përgjegjësisë politikanët dhe zyrtarët e lartë.

Të njëjtin mendim me autorin që cituam më lart, ndan edhe autori i shkrimit “*SPAK/ Makthet e politikës, dosjet dhe zyrtarët e shënjestruar*”: “Kur ndërkombëtarët thonë se politika dhe gjyqësori kanë frikë nga reforma, i referohen pikërisht SPAK-ut. Fillimisht, ngritja e SPAK u tentua të sabotohej, duke mos votuar ndryshimet Kushtetuese, por deputetët që bënë rezistencë u kërcënuan se do të futeshin në listën e zezë të SHBA. Më pas, SPAK-u u bllokua përmes zvarritjes së Vetingut nga armata e gjyqtarëve dhe një pjesë e politikës, duke ankimuar ligjin në Kushtetuese. Aktualisht, zbatimi i ligjit të SPAK-ut është bllokuar për shkak të zvarritjes së ngritjes së KLP dhe KLGJ nga politika dhe gjyqësori.”²⁰ -shkruan ai.

Në media shfaqen edhe zëra skeptikë për reformën në drejtësi. Duke iu referuar përvojës së tranzicionit, një

¹⁹ <http://www.syri.net/kronike/122154/pritshmerite-per-2018-ne-reformen-ne-drejttesi-kush-do-te-kaloje-ne-filtrat-e-spak/>

²⁰ <http://www.javanews.al/spak-makthet-e-politikes-dosjet-dhe-zyrtaret-e-shenjestruar/>

analist i njohur thekson se të dyja palët e politikës nuk e duan reformën. “Këta nuk e duan, duan të kontrollojnë drejtësinë. Nevoja për të kontrolluar drejtësinë nga të dyja palët na kanë sjellë në këtë pseudoreformë të dështuar. Do fillojë dështimi i KLP-së dhe vetingut. Ndryshimi i situatës nuk bëhej në këtë formë. Shumica kanë qenë të idesë që këtu kanë hyrë ndërkombëtarët. Ndërhyrja e ndërkombëtarëve, ky është edhe dështimi i ekspertëve ndërkombëtarë, por ata nuk mbajnë përgjegjësi.”²¹ I njëjti autor sheh tek krijimi i KLP apo KLGJ një lëmsh dhe një praktikë të paparë në ndonjë vend evropian.

Në një këndvështrim tjetër autori i shkrimit “*Reforma në drejtësi: a po na shpërfaq si një vend kolonial?*” lë të nënkuptohet se praktikatat e kontrollit të reformave nga ndërkombëtarët kanë një lloj ngjashmërie me praktikatat kolonialiste të kontrollit.²²

Po pavarësisht nga zërat skeptikë në komente të veçanta, mediat shqiptare në përgjithësi në politikën e tyre editoriale kanë aplikuar një qasje mbështetëse dhe nxitëse ndaj reformës në drejtësi. Gjithsesi nuk kanë munguar problemet në raportimin e mediave për këtë reformë. Më poshtë po analizojmë disa prej këtyre problemeve:

²¹ <http://www.syri.net/politike/117773/analisti-reforma-ne-drejttesi-deshtoi-bashke-me-ambasadoret-hellip/>

²² *Reforma në Drejtësi, a po na përshfaq si vend “kolonial”!*, Gazeta Tema, 22 Dhjetor 2017

Raportim i politizuar dhe klientelizëm politik

Në një analizë për reformën në drejtësi një analist shprehet: “Jemi një shoqëri që ende shohim secili gjysmën e vet. Duke perceptuar ose bardhë, ose zi. Gjykuar sipas filozofisë: o me ne, o kundër nesh.”²³

Kjo ndarje e shoqërisë në dy palë kundër njëra-tjetrës e prodhuar nga politika dhe vështrimi bardh e zi i gjërave kanë “infektuar” edhe mediat në praktikën e tyre të përditshme të raportimit për reformën në drejtësi. Duke iu përshtatur orientimit pro-opozitar apo pro-mazhorancës, jo rrallë mediat kanë rrëshqitur në një trajtim apo raportim të njëanshëm dhe të politizuar të zhvillimeve që lidhen me këtë reformë.

Tipik brenda objektit të kërkimit të këtij studimi është raportimi apo trajtimi i medias lidhur me vonesën disa-mujore të krijimit dhe konstituimit të KLP. Sipas ligjit, siç e kemi përmendur edhe më lart, KLP përbëhet nga 11 anëtarë. Gjashtë prej tyre zgjidhen nga radhët e prokurorëve, dy nga radhët e avokatëve të licencuar, dy nga radhët e trupës akademike të së drejtës dhe një nga shoqëria civile.

Edhe pse ka një rol shumë të rëndësishëm për funksionimin e sistemit të drejtësisë, krijimi i KLP u vonua përtej afateve të parashikuara duke krijuar një

²³ *Gjysma e gotës plot dhe gjysma bosh, në përplasjen për Kryeprokurorin, Panorama, 19 dhjetor, 2017*

situatë bllokimi. Një nga shkaqet e vonesës ishte edhe mosparaqitja e kandidatit të shoqërisë civile.

Duke raportuar për këtë situatë, disa nga mediat shfaqen në mbrojtje të tezave të njërës prej palëve politike. Kështu në mediat proqeveritare vonesa e paraqitjes së kandidatit të shoqërisë civile paraqitet si një “plan i dështuar i Partisë Demokratike”. “Vetëm disa ditë pasi shumica në pushtet nisi procesin e zgjedhjes së një kryeprokurori të përkohshëm, befas Komisioni i Shoqërisë Civile pranë avokatit të popullit thotë se tashmë procesi është zhbllokuar dhe se është krijuar numri i domosdoshëm i kandidatëve që plotësojnë kriteret. Pas kësaj lëvizjeje duket se qëndron PD, me qëllim për të ngritur me shpejtësi KLP, për të ‘djegur’ kryeprokurorin e përkohshëm.”²⁴ - thuhet në një nga raportimet e kësaj periudhe.

Ndërkohë në mediat e opozitës raportohet se vonesa e kandidatit të shoqërisë civile u bë pengesë për krijimin e KLP, “për t’i krijuar terrenin e nevojshëm mazhorancës ta kthejë në tepsinë e vet edhe Prokurorin e Përgjithshëm, përmes zgjedhjes së një të përkohshmi!”²⁵ Në një analizë tjetër të botuar në disa nga mediat opozitare theksohet se “mungesa e KLGJ

²⁴ *Lufta për kryeprokurorin: PD zhbllokoi KLP, lëvizje për ‘djegjen’ e kryeprokurorit të ri*, Shqiptarja.com, 15 dhjetor 2017

²⁵ *Reforma në drejtësi, ambasadorët dhe shoqëria civile !...* Link: <http://www.syri.net/op-ed/116657/reforma-ne-drejttesi-ambasadoret-dhe-shoqeria-civile/>

dhe KLP i lejon partisë në pushtet të veprojë në mjegull kushtetuese, duke e pasur më të lehtë të kontrollojë procesin për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm, për zgjedhjen e anëtarëve të KED, që vlerëson anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Dhe, mbi të gjitha, duke shtyrë pa fund ngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, partia në pushtet shtyn ngritjen e Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, të përcaktuara për luftën kundër krimit të organizuar dhe luftën kundër korrupsionit të zyrtarëve më të lartë shqiptarë.”²⁶

Në media ka zënë një vend të rëndësishëm edhe retorika dikotomike që iu jep përgjigje pyetjeve të tilla, si: Kush është kundër reformës, pozita apo opozita? Kush dëshiron të kapë drejtësinë, mazhoranca apo opozita?

Duke folur me termat e politikës, në një nga mediat pranë qeverisë thuhet: “SHBA/BE dhe Partia Socialiste janë rreshtuar nga krahu i Kushtetutës”,²⁷ kurse “PD dhe LSI janë kundër SHBA&BE”. Në një media tjetër të njëjtit spektër protesta e paralajmëruar e opozitës paraqitet si një protestë kundër reformës.²⁸

²⁶ <http://www.syri.net/politike/115268/akuzat-e-pd-ja-si-gramoz-ruci-po-kap-drejtisine-me-vendimet-e-tij/>

²⁷ <http://www.javanews.al/pse-llalla-eshte-fatlum-qe-po-iken-procedure/>

²⁸ *Protesta është beteja e vërtetë e opozitës kundër reformës!*, Gazeta Tema, 17 Dhjetor 2017

Ndërkohë në një koment në mediat opozitare shkruhet: “...kemi në krye të qeverisë një Kryeministër që ...nga frika e drejtësisë së vërtetë, për të mbrojtur dhe forcuar këtë pushtet kriminal, ka nevojë të ketë nën kontroll drejtësinë”.²⁹ Në rastin e zgjedhjes së prokurorit të përgjithshëm të përkohshëm, në mediat opozitare flitet për kapje të drejtësisë nga ana e qeverisë dhe e kryeministrit Rama, për kryeprokuror të kapur, etj.

Një vend të konsiderueshëm në media ka zënë edhe diskursi që lidhet me sindromën e frikës nga drejtësia, një lloj sindrome e krijuar prej ligjëritimit politik. Edhe këtu palët dhe mediat pranë tyre janë të ndara duke akuzuar njëra-tjetrën për frikë nga drejtësia.

“A ka frikë Edi Rama nga Reforma në Drejtësi?”³⁰ - pyetet në një titullin e një shkrimi të një medieje opozitare, duke nënkuptuar që është pikërisht kryeministri ai që ka frikë nga reforma. Në anën tjetër të spektrit, në mediat proqeveritare gjejmë titujt: “Frika nga arrestimet, PD tërhiqet nga imuniteti”.³¹

Ndarja politike dhe klientelizmi politik i mediave kanë dëmtuar objektivitetin e raportimit të tyre dhe kanë ulur besueshmërinë e publikut. Politizimi i demonstruar në

²⁹ *Opozita mes Prokurorisë së kapur dhe ndërkombëtarëve të kapur*, Panorama, 22 dhjetor 2017

³⁰ <http://www.syri.net/politike/121816/a-ka-frike-edi-rama-nga-reforma-ne-drejtessi-kryeministrit-meket-dhe/>

³¹ *Frika nga arrestimet, PD tërhiqet nga imuniteti*, Shqiptarja.com, 21 Nëntor 2017

rastin e raportimit të reformës për drejtësi, jo vetëm që nuk e ka ndihmuar këtë reformë, por përkundrazi ka krijuar një klimë të pafavorshme për implementimin e saj dhe ka mbjellë konfuzion, dyshime dhe mëdyshje të publiku i gjerë.

Media si ndërmjetësuese e pingpongut politik

Duke monitoruar përmbajtjen e shkrimeve që lidhen me reformën në drejtësi, gjejmë në një nga mediat titujt e dy shkrimeve të ndryshëm që fillojnë me frazën: “Rama i përgjigjet Bashës...” dhe “Basha i përgjigjet Ramës”. Nuk është e vështirë këtu që të dallosh një situatë loje të ngjashme me pingpongun, por këtë radhë të luajtur në fushën e komunikimit nga dy palët kundërshtare të politikës. Media paraqitet në këtë rast thjesht si një “tryezë” ndërmjetësuese e pingpongut politik.

Problemi i evidentuar nga ky rast dhe nga shumë raste të tjera të raportimit të mediave është ai i shndërrimit të mediave në “sheshin e mejdanit” ku ndeshen palët e politikës. Në mungesë të një politike editoriale proaktive mediat shkruajnë për reformën në drejtësi, vetëm kur palët e politikës apo aktorë të tjerë flasin për të. Ndodh në këtë rast dukuria që mund ta formulojmë me fjalët: Nëse flet politika, atëherë ka lajm. Nëse nuk flet politika, nuk ka lajm!

Një dëshmi e kësaj situatë është edhe fakti që përmendëm më sipër: Në muajt kur ka debat të

shtuar politik, ka edhe më shumë lajme. Kështu gjatë nëntorit, kur nuk patëm zhvillime të bujshme, numri i shkrimeve të botuara apo i lajmeve të transmetuara rezultonte të ishte nga 3 deri në 6 herë më i vogël se sa në muajin dhjetor kur politika inicioi debatin e nxehtë për zgjedhjen e prokurorit të përgjithshëm.

Gjithashtu nga monitorimi vihet re se ka një numër të pakët shkrimesh “civile” jopolitike të natyrës edukuese për publikun, të cilat mund të jepnin një informacion të gjerë për reformën dhe aspektet e saj si dhe për kontekstin në të cilin zhvillohet ajo. Specialistët e fushës juridike që intervistohen nga mediat apo të cilëve iu krijohet hapësirë në to, janë shumë të paktë. Në katër gazeta kemi vetëm 5 të tillë. Zhanret e opinionit, editorialet dhe komentet mbulohen kryesisht nga analistët e politikës apo nga ata që shkruajnë për gjithçka, edhe pse nuk kanë ekspertizën e duhur për gjithçka.

Një problem tjetër i evidentuar është edhe prania apo krijimi i hapësirës në media për dhunën verbale dhe konfliktualitetin e politikës. Në gazeta dhe portale gjejmë tituj të tillë, si: “Në tavolinën e Ramës sot ka një kobure”, “Vasili, Ramës, për reformën në drejtësi, përfundove si qen i rrahur lagjeje” etj., për të cilat nuk mund të ketë një shpjegim profesional se pse do të duhet të ishin në media dhe për më tepër pse do të duhet të viheshin në krye të lajmeve.

Përmes kësaj praktike, media jo thjesht ndërmjetëson komunikimin politik të palëve; ajo bëhet ndërmjetësuese edhe e konfliktualitetit dhe e dhunës verbale politike, të cilat vetëm e trishtojnë dhe e demotivojnë publikun e gjerë, të lodhur nga konfliktualiteti i gjatë i politikës në këto 27 vjet tranzicion.

Faktori ndërkombëtar: vlerësime dhe paragjykime

SHBA dhe BE kanë qenë partnerë të rëndësishëm të Shqipërisë në reformën aktuale që po kryhet në sistemin e drejtësisë. Ata kanë nxitur amendimet kushtetuese të korrikut 2016 të cilat do të krijonin bazën për reformën e re. Siç e thamë edhe më lart mediat në përgjithësi e kanë njohur dhe vlerësuar rolin e aleatëve perëndimorë në këtë proces. Por, nën ndikimin e politikës, nuk kanë munguar në media edhe paragjykime apo akuza për rolin dhe veprimtarinë e përfaqësuesve të SHBA dhe BE në Tiranë.

Akuzat më të ashpra dhe paragjykimet më të theksuara vijnë këtë radhë nga mediat pranë opozitës, si reflekse të gjuhës së politikanëve të spektrit nga i cili anojnë këto media. Por nuk mungojnë kritikrat dhe paragjykimet edhe në mediat pranë pushtetit si edhe në disa shkrime që mbajnë firmën e analistëve të konsideruar si të pavarur.

Duke paragjykuar rolin e ambasadorit amerikan në Tiranë, Donald Lu si dhe të ambasadores së BE,

Romana Vlahutin, redaksia e një medieje opozitare vendos në një koment të një analisti titullin: “Lu e Vlahutin, dordolecë në duart e Ramës” (titulli i autorit në origjinal ishte “Farsa qesharake e çiftit Lu –Vlahutin) dhe e shoqëron shkrimin me foto të montuar në të cilën janë shtuar detaje për të krijuar idenë e dordolecëve. Një shkrim tjetër në të njëjtën media mban titullin “Donald Lu bëhet palë”, duke nënkuptuar që është bërë palë me kryeministrin në procesin e zgjedhjes së kryeprokurorit.

Në mediat opozitare sillen edhe disa deklarata të përfaqësuesve të opozitës kundër ambasadorit amerikan dhe ambasadores së BE, duke vendosur qysh në titull emrat e ambasadorëve dhe akuzat ndaj tyre, si për shembull në shkrimet me titull: “Shpërthen Vasili: Lu dhe Vlahutin, po silleni si pushtues”, “Çlirim Gjata në Syri.net: Lu dhe Vlahutin, ju ra reforma në drejtësi...”, etj. Edhe pse në brendësi të shkrimeve nuk përmenden me emër ambasadorët, por lihen të nënkuptohen, redaksia zgjedh që t’u vërë emrin, madje që në titull, duke pasqyruar në këtë rast një pozicion edhe më të avancuar se vetë politikanët në kritikën e tyre ndaj dy përfaqësuesve të lartë të institucioneve perëndimore. Në këtë rast mund të flitet jo thjesht për politizim të raportimit, por për një klientelizëm politik përtej çdo lloj standardi të medias.

Në këtë aksion angazhohen në raste të caktuara edhe analistë të pavarur. Njeri prej tyre flet për “ndërkombëtarë të kapur” dhe e shpjegon në këtë

mënyrë “kapjen” e tyre: “Pa hyrë gjatë në këtë histori, do të thosha se ajo fillon që nga korrupsione të ambasadorësh të veçantë e interesa shtetesh e biznesesh të tyre, deri te fakti se ndërkombehtarëve, veçanërisht Brukselit, i intereson të mbajnë gjallë narrativën se Shqipëria ka bërë hapa përpara në këtë tranzicion të pambaruar dhe jo të pranojnë faktin se sot nuk bëhet më fjalë për një rrugë drejt demokracisë, por për rrugën drejt instalimit të një regjimi antidemokratik me bazë ekonomike paratë e kimit.”³²

Pasi flet për “një situatë ku regjimi i gangsterëve të Ramës mbështetet nga ndërkombehtarë”, i njëjti autor konkludon se “në kushtet e sotme opozita ndodhet përpara një rreziku më të madh se opozitat e mëparshme, të cilat, siç e thashë më sipër, drejtësia i ka lënë të qeta. Ajo ndodhet midis një dare që ka si dhëmbë më një anë Prokurorinë e kapur dhe në anën tjetër ndërkombehtarët e kapur...”³³

Gjithsesi, nuk mungojnë zërat e arsyeshëm, që ruajnë qartësinë dhe ekuilibrin, edhe në momente krizash të tilla politike. Në një analizë për situatën e krijuar në rastin e zgjedhjes së kryeprokurorit dhe për akuzat ndaj ambasadorëve, shkruhet: “A ka sens të mendohet se amerikanët dhe evropianët në një anë po hapin kutinë e zezë të krimeve të pandëshkuara në Shqipëri,

³² *Opozita mes Prokurorisë së kapur dhe ndërkombehtarëve të kapur*, Panorama, 22 dhjetor 2017

³³ Po aty

në anën tjetër po i japin Edi Ramës një çelës për ta mbyllur, apo për të seleksionuar çështje sipas interesit të tij në këtë kuti? Nuk ka pikë sensi”.³⁴

Për këtë autor, “ngjarjet dhe zhvillimet e fundit nga fronti i Prokurorisë tregojnë se kauza opozitare dhe popullore për një Shqipëri të ligjit dhe zgjedhjeve të lira përputhet me angazhimet e sotme e të nesërme të partnerëve amerikanë e evropianë dhe mund të ketë sukses vetëm duke punuar ngushtë me ta”.³⁵

Duhet thënë gjithashtu se paragjykimet nuk i gjejmë vetëm në anën e mediave opozitare. Një lloj paragjykimi ndaj pozicionit të aleatëve perëndimorë është shfaqur edhe në mediat pro qeverisë, të cilat flasin për “shumicë që ka mbështetjen e SHBA dhe të BE” apo për një lloj rreshtimi në të njëjtin krah të me PS të SHBA dhe BE, kur shkruajnë: “...njëlloj si për reformën në drejtësi, edhe për çështjen e kryeprokurorit, SHBA/BE dhe Partia Socialiste janë rreshtuar nga krahu i Kushtetutës”.³⁶

Ndërkohë në media nuk kanë munguar edhe teoritë e konspiracionit. Është i njohur fakti se përdorimi i teorive të konspiracionit shpesh bëhet për të krijuar konfuzion dhe për të larguar vëmendjen e publikut të gjerë nga thelbi i proceseve apo i zhvillimeve. Nga monitorimi i kryer rezulton se në disa media nuk

³⁴ *Kryeprokurori i antikriminit*, Panorama, 24 nëntor, 2017

³⁵ Po aty

³⁶ <http://www.javanews.al/pse-llalla-eshte-fatlum-qe-po-iken-procedure/>

mungojnë të shfaqen edhe teoritë e konspiracionit që lidhen me aspekte të ndryshme të reformës në drejtësi.

Praninë e teorive të tilla e përmend edhe autori i komentit *Gjysma e gotës plot dhe gjysma bosh, në përplasjen për Kryeprokurorin* i cili shkruan lidhur me raportimin e mediave për çështjen e kryeprokurorit: "...kishte nga ata që panë prapa gjithë kësaj zhurme teorinë konspirative të radhës me fije të tërhequra nga duart e padukshme që nisnin nga Edi Rama, vijon në Rrugën e Elbasanit, kalonin nga selia e BE dhe për t'u nisur në udhëtim larg e më larg, deri në Bruksel dhe Uashington."³⁷

Në media është ndeshur edhe paragjykimi për FBI dhe rolin e saj në reformën në drejtësi dhe në veprimtarinë e ardhshme të SPAK. Kështu një gazetë opozitare shprehet me dyshim për rolin e tyre dhe për faktin që "janë paguar nga fonde të panjohura për taksapaguesit amerikanë".

Gjatë monitorimit janë konstatuar edhe paragjykime për aspekte të veçanta të reformës. Në një nga mediat e monitoruara gjejmë titullin "Si do të spiunohen gjyqtarët dhe prokurorët" i cili i referohet praktikës se si do të denoncohen nga ana e publikut aktet e korrupsionit nga ana e gjykatësve dhe prokurorëve. Në kontekstin e gjuhës shqipe, përdorimi i foljes spiunoj, jo vetëm që shpreh një lloj paragjykimi për procesin,

³⁷ *Gjysma e gotës plot dhe gjysma bosh, në përplasjen për Kryeprokurorin*, Panorama, 19 dhjetor, 2017

por ndikon negativisht tek publiku, duke e demotivuar atë që të raportojë për rastet e korrupsionit dhe të mitmarrjes dhe për rrjedhojë kontribuon në uljen e efektivitetit të reformës në drejtësi.

Paragjykimet dhe teoritë e konspiracionit shpesh prodhojnë hipoteza të cilat krijojnë një pamje të rreme tek publiku i gjerë. Përdorimi i tyre bie ndesh me standardet profesionale të medias që kërkojnë një informim të bazuar tek faktet dhe jo tek opinionet. Për këtë arsye prania e tyre në faqet e medias ul ndjeshëm reputacionin e tyre dhe e largon publikun e gjerë.

Tabloidizim dhe personalizim i informimit

Në raportimin e mediave për reformën në drejtësi, ashtu siç ndodh edhe me raportimin në përgjithësi, nuk kanë munguar edhe rastet e cektësisë në raportim apo rastet ku autorët merren me vogëlsira dhe detaje anësore, duke reflektuar nuanca të tabloidizimit në raportim. Në mënyrë të përmbledhur këtë situatë e sjell edhe autori i një shkrimi që e kemi përmendur më sipër, në të cilin analizohet mënyra e raportimit nga ana e medias të zgjedhjes së kryeprokurores së përkohshme. Ja si shkruan ai:

“Kemi dëgjuar zëra të rëndësishëm mediatikë që nuk panë asgjë tjetër, veç e kuptuan menjëherë se Prokurorja e re e Përkohshme ishte bërë ende pa hapur gojën “vegël e Rilindjes”. Pasi e hapi gojën dhe tha fjalën

“BETOHEM”, sigurisht që bëri totalisht lojën e Edi Ramës. Kishte të tjerë që panë vetëm antikushtetueshmërinë e seancës, apo ...u morën me çizmen e znj. Kryemadhi, markën e saj, formën, çmimin, numrin e këmbës, nëse i kishte blerë brenda apo jashtë. Apo ...shkuan deri te materniteti i bebes së Kryeprokurores së Re; te nëna e saj që nuk mungoka në asnjë prej mitingjeve të PD; te kushërinjtë e saj që paskëshin qenë nacionalistë dhe pinjollë të një dere të madhe,”³⁸ etj.

Në disa prej artikujve, gjatë raportimit apo analizave është konstatuar edhe një personalizim i debatit. Më shumë se sa për procesin, flitet për personat, duke arritur deri në një lloj largimi nga thelbi i gjërave dhe duke u marrë me aspekte dytësore.

Artikulli me titull “Ikja e shëmtuar e Tikut” është një shembull i qartë i këtij personalizimi. Që në përdorimin e formës së shkurtuar të emrit të ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla në titull, lexohet një qëndrim jo ndaj kryeprokurorit si funksion, por ndaj personit vetë.

Në një shkrim tjetër, zgjedhja e kryeprokurorit të ri konsiderohet si “hakmarrja e Lu ndaj Llallës”.³⁹ Në të njëjtën tipologji, në artikullin “*Lëvizje llalliste e opozitës, si revolucioni i ri kundër “imperializmit amerikan”*” lexojmë: “E nisur që në vitin 2016, kjo lëvizje

³⁸ Alfred Peza, *Gjysma e gotës plot dhe gjysma bosh, në përplasjen për Kryeprokurorin*, Panorama, 19 dhjetor, 2017

³⁹ <http://www.syri.net/politike/113088/hakmarrja-e-lu-ndaj-llalles-si-bekim-per-prokurorin-e-ri-te-edi-rames/>

lindi nga një pjesë e politikës shqiptare për të mbrojtur kryeprokurorin Adriatik Llalla, i cili u konfrontua, me Ambasadën amerikane në Tiranë, që u hoqi vizat e SHBA-së, vetë Llallës dhe bashkëpunëtorëve të tij kryesorë.”⁴⁰

Në linjën e personalizimit, gjejmë edhe disa artikuj të cilët e lidhin reformën në drejtësi me persona të veçantë duke aluduar se kjo reformë është ndërmarrë për të dënuar “x” apo “y” person.

Por, siç shkruan me të drejtë një analist, reforma në drejtësi “nuk është fare çështje personash të klasit të dytë, apo të parë. ...Kësaj radhe gjërat janë ndryshe. Evropianët dhe amerikanët e kanë ngritur ndryshe stekën dhe thelbi nuk drejtohet drejt ndëshkimeve të karakterit thjesht individual, siç mendon një pjesë e madhe e opozitës apo edhe individë të pozitës.”⁴¹

⁴⁰ “Lëvizje llalliste” e opozitës, si revolucioni i rikundër “imperializmit amerikan”, Gazeta Tema, 17 Dhjetor 2017

⁴¹ <http://www.javanews.al/llogaritari-calaman-kryeprokurori-dhe-vdekja-e-klases-politike/>



Përfundime

Reforma në drejtësi ka qenë pa dyshim një nga proceset më intensive institucionale në historinë e tranzicionit shqiptar. Ajo ka zgjatur më shumë se tre vjet, ka prodhuar një reformë të thellë kushtetuese dhe dhjetëra ligje dhe akte të tjera teknike, ka krijuar një sërë institucionesh të reja dhe është shoqëruar, praktikisht në çdo hap dhe moment, nga polemika dhe tensione të vazhdueshme politike. Dhe prapëseprapë jemi vetëm në fazat e para të zbatimit të saj. Në këto rrethana, mbulimi mediatik i këtij procesi do të kishte qenë një sfidë e konsiderueshme edhe për vende me sektorë informativë të konsoliduar.

Si i është përgjigjur kësaj sfide media shqiptare? Rezultatet e këtij studimi japin një tablo mjaft komplekse.

Në anën pozitive, mediat i kanë kushtuar vëmendje dhe burime të konsiderueshme mbulimit të reformës, duke mbajtur të informuar publikun për momentet kyçe dhe

qëndrimet e faktorëve kryesorë, vendas dhe të huaj. Qasja ndaj reformës ka qenë përgjithësisht pozitive, të paktën në parim, pa venë në dyshim nevojën për të “kuruar” problemet serioze nga të cilat vuan sistemi aktual i drejtësisë shqiptare dhe pritshmëritë e publikut në këtë drejtim. Po ashtu, nuk kanë munguar edhe disa përpjekje serioze për të diskutuar, në mënyrë objektive, elementët e ndryshëm dhe kompleksë të reformës dhe për të hedhur dritë mbi arkitekturën e re të sistemit të drejtësisë.

Në të njëjtën kohë, siç tregon qartazi analiza e mësipërme, në mjaft aspekte të tjera mbulimi mediatik i reformës dhe sidomos të tre institucioneve në fokus të këtij studimi ka qenë problematik. Mëkatet kryesore mund të përmbliidhen në dy aspekte, të ndërlidhur me njeri-tjetrin: politizim i theksuar dhe cektësi në raportim.

Të dy elementët janë ndoshta më të dukshëm në mungesën e raportimit objektiv dhe të sofistikuar mbi një temë që natyrisht ka edhe kompleksitetet e veta (juridike, të procedurave parlamentare, aspekte institucionale etj). Është fakt i njohur se janë shumë të pakta mediat shqiptare, qoftë dhe ato më të fuqishme financiarisht, që punësojnë (me kohë të plotë ose të pjesshme) gazetarë apo analistë jo thjesht me formim juridik, por me përvojë të mjaftueshme në fushën e së drejtës dhe talentin për të zbërthyer konceptet juridike në një gjuhë të kuptueshme për publikun e gjerë.

Në mungesë të gazetarëve dhe analistëve të specializuar (dhe këtu nuk është fjala vetëm për atë që ndjekin kronikën e zezë), diskutimet mediatike mbi këto tema mbeten në domenin e të njëjtëve analistë “të gjithëditur” dhe “ekspertëve” të politizuar që mbushin faqet dhe ekranet tona natë pas nate. Përveç mangësive në informimin e publikut në mënyrë të besueshme, kjo mungesë krijon edhe një problem akoma më të madh për mediat: paaftësinë për të kërkuar llogaridhënie reale nga aktorët politikë.

Si rrjedhim, mbulimi mediatik politizohet skajshëm (edhe kur ndoshta nuk është e qëllimshme) dhe tenton drejt cektësisë banale. Një ilustrim i mirë mbi këtë pikë është çështja e vonesave në konstituimin e dy këshillave (dhe sidomos të KLP-së) si rrjedhim i mungesës së një numri të mjaftueshëm kandidatësh nga radhët e shoqërisë civile dhe në njëfarë mase nga akademia. Ky ishte një problem real dhe i rëndësishëm, por që rezultoi në tjerren e një morie teorish konspirative mediatike dhe hamendësimesh kafeneje.

Ajo që mungoi ishte një analizë serioze dhe e kthjellët mbi shkaqet e këtij problemi, i cili nuk buronte as nga mangësitë (e supozuara) të komisionit të krijuar me ligj për vlerësimin e kandidatëve dhe as nga ndonjë “komplot” tjetër -- përpos faktit që, për arsye të ndryshme, prurja e kandidatëve të kualifikuar nga shoqëria civile që pranuan të aplikojnë ishte aq e ulët saqë Komisioni nuk mund të përmbushte detyrimin ligjor për t’i përcjellë Kuvendit një listë me të paktën tre

kandidatë për çdo vend vakant. Do të kishte qenë shumë më e dobishme që debati mediatik të përqendrohej në shkaqet e kësaj prurjeje të dobët, në vend të teorive konspirative; në fakt, asnjë media e vetme nuk pati një trajtim serioz të këtij këndvështrimi.

Të njëjtat probleme u shfaqën, madje edhe më të theksuara, në procesin e zgjedhjes së anëtarëve jomagjistratë të të dy Këshillave, i cili u zhvillua në Kuvend gjatë periudhës janar-shkurt 2018. Formula kushtetuese, e dakorduar në minutën e fundit dhe e votuar unanimisht nga të gjitha palët në korrik 2016, është bazuar mbi parimin e konsensusit të gjerë politik në zgjedhjen e anëtarëve jomagjistratë, duke qenë se kërkon një shumicë prej 4/5 të votave në nënkomisionin ad hoc dhe 2/3 e votave në seancë plenare. Procesi mund të përsëritet deri në tre herë rresht, pikërisht për t'i dhënë mundësi gjetjes së kompromisit. E njëjta formulë parashikon shortin si një mekanizëm zhbllokues për ato raste kur konsensusi nuk është i mundur për një kandidat të caktuar: një e keqe kjo juridikisht e nevojshme, në mënyrë që të shmanget bllokimi i procesit në situata përjashtimore.

Por përjashtimi u kthye në rregull. Fakti që absolutisht të gjithë anëtarët laikë të Këshillave përfunduan në zgjedhjen “me gogla” tregoi qartë se njëra nga (apo të dyja) palët politike nuk tregoi kurrfarë interesi të investohej në gjetjen e kandidatëve konsensualë, duke nëpërkëmbur kështu frymën e Kushtetutës së hartuar nga ata vetë. Zgjidhja e goglave la një shije mjaft të keqe

te publiku i gjerë (dhe, me shumë gjasë, te kandidatët e ardhshëm potencialë), sepse zëvendësoi logjikën e zgjedhjes së kandidatëve më të mirë, në bazë të meritave, me logjikën e rastësisë. Kjo lojë politike ka dëmtuar kredibilitetin e dy këshillave dhe mund të sjellë pasoja negative afatgjata për zbatimin e një pjese të rëndësishme të reformës në drejtësi. E megjithatë, në emër të një asnjësie të rreme, mediat u mjaftuan me përcjelljen e ping-pongut politik, pa ndërmarrë hulumtime të thelluara për shkaqet e mosarritjes së konsensusit dhe pa gjeneruar llogaridhënie nga palët përgjegjëse për këtë dështim të procesit politik.

Në qoftë se misioni i medias në një demokraci është që “t’ia përplasë të vërtetën në fytyrë” politikës, duket se më së shumti politika shqiptare ja del të përplasë “të vërtetat e veta alternative” në faqet e mediave dhe audiencës së tyre.

Së fundmi, është me interes të cekim edhe mbulimin mediatik të rolit të faktorëve ndërkombëtarë (veçanërisht përfaqësuesve të BE-së, SHBA-së dhe disa ambasadave evropiane), të cilët mund të thuhet se janë investuar në këtë proces në mënyrë të paprecedent, të paktën që prej krizës së vitit 1997. Vlen të theksohet se ky angazhim ishte jo vetëm në nivel politik, por edhe teknik: p.sh. secila nga shtatë shtyllat e Komisionit të Reformës kishte edhe një bashkëkryetar ndërkombëtar, disa prej të cilëve u përfshinë imtësisht në hartimin e amendamenteve kushtetuese.

Duke pasur parasysh këtë angazhim të jashtëzakonshëm të faktorit ndërkombëtar, ishte në njëfarë mase e pashmangshme (dhe e drejtë) që këta të fundit të bëheshin objekte të vëmendjes së shtuar mediatike përgjatë procesit të reformës, përtej kortezeve të zakonshme diplomatike. Analiza e këtij studimi tregon se politizimi i skajshëm i mbulimit mediatik nuk i kurseu as faktorët ndërkombëtarë. Në atë masë që mediat në Shqipëri janë zgjatim i pafiltruar i politikës, diplomatët e akredituar në Tiranë do të duhet të kenë “lëkurën e trashë” që kërkon sporti i vështirë i jetës publike në këtë vend.